



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 21.10.2020)*

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 17:00 dhe mbaroi në orën 17:03.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i>   | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Maksim Qoku</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i>         | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>4. Fatmira Luli</i>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>10. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

*4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

*5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe në Gjykatën e Apelit Korçë, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.<sup>1</sup>

Pasi verifikohet prezenca dhe kuorumi i nevojshëm i anëtarëve për trajtimin e çështjes “Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe në Gjykatën e Apelit Korçë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje të rendit të ditës është zoti Ilir Toska.

Shkurtimisht parashtrohet se ditën e sotme kanë mbërritur 2 kërkesa urgjente nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykata e Apelit Korçë, përmes të cilave kërkohet caktimi i gjyqtarit për të gjykuar çështje të karakterit tepër urgjent që kanë të bëjnë me caktim mase sigurimi apo zëvendësim mase sigurimi.

Fillimisht trajtohet relacioni për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Gjithashtu Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

---

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti: Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, z.Arben Dosti; Gjyqtarja e gatshme e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, znj.Suela Dashi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Blerta Çibuku.

Më tej trajtohet relacioni për Gjykatën e Apelit Korçë.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale, me karakter “tepër urgjent”.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 1, saç është nevoja.

Gjithashtu Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: z. Ridvan Hado.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët janë në listën e gatishmërisë së kësaj gjykate përgjatë kësaj jave, konkretisht: z. Gramoz Levanaj, z. Asim Vokshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Zegjine Sollaku.

Me kaq mbyllen procedura e shortit dhe kjo çështje e rendit të ditës.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**